



Kush e nxjerr aktin përfundimtar të transferimit?

Njësia përgjegjëse merr vendimin përfundimtar të transferimit pas marrjes së propozimit të arsyetuar të Komisionit të Ristrukturimit.

Si formohet Komisioni i ristrukturimit?


Komisioni i Ristrukturimit drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të:

- Institucioneve ku nëpunësi është emëruar.
- Institucioneve, me të cilin institucioni është shkrirë apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi.
- Institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;
- në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Sa kohë para ristrukturimit/mbylljes njësia përgjegjëse duhet të njoftojë nëpunësit?

Njësia përgjegjëse detyrohet që të njoftojë individualisht nëpunësit e institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet 1 muaj përpara për fillimin e procedurës.

STRUKTURIMI & RISTRUKTURIMI I INSTITUCIONIT



042 26 8141



info@kmshc.al;
kmshc@kmshc.al



Rruga: "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini", Tiranë



www.kmshc.al

Çfarë kuptojmë me strukturim të institucionit?

Strukturimi i institucioneve nënkupton organizimin e brendshëm të një institucioni të krijuar për herë të parë (struktura dhe organika). Strukturimi i institucionit fillon në momentin e krijimit të një institucioni.

Çfarë kuptojmë me ristrukturim të institucionit?

Ristrukturimi nënkupton procesin e riorganizimit të institucionit, i cili shoqërohet me ndryshime thelbësore të brendshme të strukturës dhe organizimit të tij.

Kur ndodh ristrukturimi i institucionit?

- Ka pasur ndryshime të misionit të institucionit.
- Janë shtuar apo pakësuar vende pune si pasojë e ndryshimit të funksione të institucionit.
- Kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës.
- Kërkohe një rishpërndarje e ndryshme e burimeve të shtuara apo të pakësuara për kryerjen e funksioneve.

Kur fillon transferimi i nëpunësve?

Procesi i transferimit të nëpunësve/punonjësve fillon në momentin e nxjerrjes/miratimit të aktit administrativ që miraton strukturën dhe organikën e re të institucionit.

Cili është organi i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të nëpunësve në rast ristrukturimi/mbyllje?

Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, apo të një kategorie më të ulët vetëm me pëlqimin e tij, ku vlerësohet se nëpunësi i plotëson kërkesat specifike të vendit të punës.

A lejohet lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit?

Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur, si pasojë e këtyre procedurave ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë.

